



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 11.3.2025

Nr: 260

Ora: 17:00

VENDIM
PËR

**MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHËSVE QË VOTOJNË
JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR ZGJEDHJET PËR
KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenit 25, pika 7, dhe nenit 47, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Miratimin e listës përfundimtare të zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, të nxjerrë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile.
2. Publikimin e listës përfundimtare të zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kopje elektronike e listës përfundimtare të zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, ruhet në protokollin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 11.3.2025 Nr: 260
Ora: 17:00



“Për miratimin e listës përfundimtare të zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”